



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 93, datë 22.09.2023

PËR  
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË  
BACHELOR NË “ADMINISTRIM BIZNESI”, ME PROFILE “ADMINISTRIM  
BIZNESI”; “MARKETING”; “EKONOMI BIZNESI”; “MENAXHIM”, TË  
UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT NË TIRANË.

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, me profile “**Administrim Biznesi**”, “**Marketing**”, “**Ekonomi Biznesi**”, “**Menaxhim**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, me profile: “**Administrim Biznesi**”, “**Marketing**”, “**Ekonomi Biznesi**”, “**Menaxhim**”, të Universitetit të New York-ut në Tiranë.
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 231, datë 19.07.2021
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrimit të Biznesit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra

- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e studimit: Anglisht
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
  - 1. Ngarkesa në orë e lëndë mësimore e disa prej anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në këtë program studimi, është e lartë.
  - 2. Mungesa e detajimit në syllabuset e programit të studimit e të gjithë elementëve të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
  - 3. Mungesa e një sistemi të menaxhimit të brendshëm të informacionit, në funksion të këtij programi studimi.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*

**VENDOSI:**


1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, me profile “**Administrim Biznesi**”, “**Marketing**”, “**Ekonomi Biznesi**”, “**Menaxhim**”, të **Universitetit të New York-ut në Tiranë**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21.09.2027**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I AKREDITIMIT


SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar

DARINKA PIQANI




Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

**Shënim:** Z. Maurice Oudejans, nuk mori pjesë në këtë mbledhje.

## Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 93, datë 22.09.23, “Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, me profile “**Administrim Biznesi**”, “**Marketing**”, “**Ekonomi Biznesi**”, “**Menaxhim**”, të **Universitetit të New York-ut**, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës në orë e lëndë mësimore të disa prej anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në këtë program studimi, të cilët rezultojnë me ngarkesë të lartë.
2. Institucioni, të përditësojë syllabuset e këtij programi studimi duke detajuar në to të gjithë elementët e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të marrë masa për krijimin e një sistemi të menaxhimit të brendshëm të informacionit, me qëllim rritjen e komunikimit e ndërveprimit midis studentëve të këtij programi studimi dhe personelit akademik.
4. Institucioni, të shohë mundësinë e rritjes së numrit të lëndëve të përshtatshme me profilet e ofruar të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të rrisë përpjekjet për tu angazhuar më tepër në projekte kërkimore shkencore, me qëllim rritjen e mundësive për kualifikim të mëtjshëm e mobilitete, të personelit akademik e studentëve të këtij programi studimi.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti i New York - ut në Tiranë** duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

